

Fjalim i deputetit Petrit Vasili

03.07.2023

E nderuar Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë!

Absolutisht, sikurse e shikoni edhe në këtë sallë, sot që duhej të ishte dita e debatit të madh për drejtësinë, ata që drejtojnë institucionet nuk janë fare në sallë. Nuk kanë kohë të shpenzojnë as edhe një ditë të vetme në Kuvendin e Shqipërisë, në vendin ku ata raportojnë. Kjo është prova e asaj që quhet “kooperativa rilindase në drejtësi”. Po ashtu, edhe të gjitha raportimet, siç e patë, u bënë kooperativë. Në lidhje me të gjitha raportimet e institucioneve të tjera, që kanë rëndësi e peshë të jashtëzakonshme publike, por jo peshën që ka drejtësia, diskutimet kanë qenë korrekte, të ndara dhe me shumë përgjegjësi, ndërsa sot, sikundër e vutë re, pamë një tog të madh muhabetesh, sa për të kaluar radhën, sepse sigurisht, ai që është misioni kryesor i drejtësisë për ta kapur, ka ndodhur. besoj se ky ishte edhe rezultati më i madh që ajo ka arritur. Megjithatë, ka disa pyetje të njëpasnjëshme, lidhur me çfarë diskutuan të gjithë bashkë, sa i përket asaj që ka prodhuar reforma.

A ka përmirësuar kjo reformë ndonjë gjë për qytetarët? Siç e dini, edhe në mënyrën si i kanë sonduar qytetarët, jo vetëm që mungon besimi, por ekziston një zhgënjim i jashtëzakonshëm. Për fat të keq, shumë qytetarë po thonë me gojën plot: ishte më mirë kur ishte më keq. Nuk ka një tregues të vetëm, pas shtatë vjet të miratimit të reformës, ndërkohë që jemi në korrik të vitit 2023. Në këtë sallë, reforma është miratuar me 140 vota, ndonëse më pas kemi dëgjuar se reforma ishte e Partisë Socialiste, se e kemi bërë ne, se po të mos ishim ne reforma nuk do të ndodhte kurrë. Pra, dënglat e përhershme të atyre që janë dënglaxhi të specializuar. 140 vota kanë marrë në këtë sallë.

Po sot, pas shtatë vjetësh, çfarë ka ndodhur? Nuk u thonë dot qytetarëve as edhe një tregues të vetëm, një të vetëm, që pohon se dje ishte keq, ndërsa sot është më mirë. Flasin për male dosjesh, flasin për mijëra njerëz, që ikin pa marrë drejtësi, por gjëja kryesore për të cilën duan të flasin, por nuk flasin, është pandëshkueshmëria e betonuar. Pra, duhet t'i dridhet mishtë atij që ka një problem apo ndonjë shpërdorim të energjisë elektrike me 50 mijë lekë apo 100 mijë lekë të vjetra, ama nuk ka fare problem për ata që kanë 140 milionë euro nëpër ndërmarrje, nuk kanë përgjegjësi. Zhurmë e madhe, gëlon media, kur zihet një sekretare, e cila paska shpërdoruar, por ka imunitet ai që rrëmben 430 milionë euro. Drejtësi shumë e qetë, se s'ka lajme, s'ka njoftime. Vijnë lajme që nga Brukseli: keni problem të madh me Portin e Durrësit, ka korrupsion parlamentar e korrupsion qeveritar të të gjitha niveleve. Brukseli shqetësohet, ndërsa këta janë shumë të lumtur. Ne jemi shumë mirë, nuk kemi lajme, nuk dëgjojmë gjë, dhe drejtësia vazhdon të funksionojë.

Gjithashtu, kemi dëgjuar edhe për ndryshime ligjesh. Sot pati edhe miklime reciproke, thirrje përgjegjshmërie në opozitë e të tjera e të tjera. Po mirë, për këta zotërinjtë që bënë reformën në

drejtësi, njëri prej të cilëve kam qenë edhe unë: ku vajti ai Komiteti i Ekspertëve të nivelit të lartë? Sepse u tha se politika s' do fusë më duart te drejtësia. Po këta i kanë futur duart njëzet herë, more! Thuhej: larg qeveria, larg politika! Ekspertët, vetëm ekspertët. Ata, vetëm ata, të mos flasë njeri tjetër! Sigurisht, ekspertët i futën të gjithë nëpër institucione, s'ka rëndësi. Po ku janë? Ku është Komisioni i Venecias, që certifikonte çdo paragraf? Si harruan këta? Sepse disa prej tyre janë edhe në sallë. Si harruan? Atëherë bënin be, nuk fushnin dot dorën. Jo, jo, se kanë thënë ekspertët e nivelit të lartë: ne nuk prekim gjë.

Kemi qenë në komision. Për fat të keq, janë edhe të regjistruara. Po sot? Pazari i gjësë: dhjetë ligje përnjëherësh. Ca i bënë me atë parlamentin mysybet në dynja, për turp të Zotit, nja dhjetë të tjera i kanë lënë aty, në prag të beharit, para se të iknin në vrap e sipër.

Pra, me demokracia reforma u ndërtua si apolitike, e pavarur, por si përfundoi? Ia shkull për ditë tullat politika dhe e shndërron në një karakter të teneqeje, që nuk u ofron asgjë qytetarëve shqiptarë. Zero u ofron qytetarëve shqiptarë, vetëm zhgënjim e demoralizim të jashtëzakonshëm. Japin shifra. Po çfarë shifrash japin këtu? Po ja, në datën 16 ishte kryetarja e KLGJ-së, dhe tha se duhen 16 vjet të marrësh drejtësi në Gjykatën e Apelit Tiranë. Çfarë gënjejnë me shifra? U shqepën duke gënjyer. Po qytetarët janë gjallë. Po bëni qejfin tuaj duke gënjyer sallën? Po ne nuk na gënjeni dot. Ata s' i gënjeni dot, se po vuajnë e po heqin të zitë e ullirit. Me mijëra e mijëra dosje janë atje. Por do të rritet cilësia, sepse evadojnë nga 3 mijë. Po ku është kjo cilësi e lartë? Se kjo reforma në drejtësi u bë që të kishim integritet moral, por të kishim edhe cilësi të lartë. Pse, rritet cilësia duke bërë mijëra raste, ë? Veç nëse ka të tillë supermenë dhe tërë bota juridike në mbarë globin janë kaq idiotë, kaq të trashë, nuk janë aq të zotë sa këta tanët. Ata mezi bëkan dhjetë dosje, ndërsa këta i këpusin një mijë. Epo, këto emulacionet socialiste lërjani asaj kohës tjetër, kur nuk kishte as avokatë e asgjë. Por ndoshta ju keni nostalgji e merak të madh që të shkoni drejt atij modeli, që i rrënon përfundimisht njerëzit. Kjo është e vërteta.

Pra, të gjitha ligjet e ndërtuara me një rregull të caktuar, me një kredo të caktuar, që politika nuk do t' i fusë duart, tani vini tak e tak: po ja, se merremi vesh me ca nga opozita, sepse ka ca të përgjegjshëm këtu në opozitë, dhe vajtëm e i ndërruam. Po ku ishin këto: analiza e sistemit, raporti, propozimet e ekspertëve të nivelit të lartë? Ku i çuat? Po as konsekuencë në punën që bëni vetë, nuk keni?! Do të thoni ju: kjo është çështje turpi, dhe kur të plas cipa, s'ka problem. Po mirë, dakord! Po këta politikanë nuk quhen politikanë, por quhen cipëplasar.

Cilat janë elementet e tjera? Patëm një veting, që duhej të ishte zemra dhe kryefjala e sistemit, me dy standarde, që qindra milionat e atyre gjykatësve të partisë nuk i shikonte, por shikonte qindarkat e të tjerëve. Po çfarë kishin tjetër? Edhe në Strasburg përfundoi. Edhe aty mori goditje. Po çfarë ishte? A duhej të ishte proces steril? Po, steril duhej të ishte. Po të mos ishte steril, nuk vlente, zero vlente si veting. Por çfarë duhej të luftonte reforma në drejtësi? Kishte merak të luftonte korporatizmin midis gjyqtarëve, por erdhi një damlla edhe më e zezë se korporatizmi: erdhi nepotizmi. Të paktën, shqyr Zotit, këtë nuk kanë kurajë ta mohojnë: vëllezër, motra ministrash, ish-ministrash, të gjithë atje i keni. Kalojnë herë te njëra dorë, herë te tjetra, por aty i keni. Këta i

kemi tanët, edhe ata tanët i kemi. Nuk besoj se keni paturpësinë ta mohoni këtë. Edhe në krye të institucioneve të drejtësisë, që s'janë fare këtu, se s'na begenisin ne, ndërsa juve jua kthejnë borxhin nëpër gjykata e nëpër SPAK, nuk ju trazon njeri, ndaj s'kanë pse rrinë fare ata këtu. Shumë mirë, pranojeni këtë standard, se këtë standard të krenarisë individuale keni ju. Pra, nepotizëm kokë e këmbë.

Kjo reformë nuk duhej të pranonte qoftë edhe një rast të vetëm nepotizmi, pasi u ngrit mbi kredon e një puritanizmi të jashtëzakonshëm juridiko-politik dhe të besnikërisë ndaj Kushtetutës e ligjit. Por si ka degraduar? Ka degraduar në atë farë feje, pa din e pa iman, pa asnjë limit apo afat që të jetë respektuar. As dhe një i vetëm nuk është respektuar. Gjithsesi, thoni: reforma ecën pak; po ja, ndokush edhe ndëshkohet. Ai që vë firmën e madhe nuk ndëshkohet, dihet që nuk ndëshkohet, por as ai tjetri që ka firmën e madhe nuk ndëshkohet. Është e madhe afera e gjeneratorëve, por ja, Edi Ramën dhe Erion Velinë nuk i prekim dot, por po merremi me këta. Kënaquni! E shikoni? Drejtësia po punon. Ja, e mori njërin dhe e futi atje. Ja edhe kjo sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe u mobilizuan të gjitha mediet e portalet, që kohen nga supa e qeverisë, për të krijuar tymnajën e madhe të radhës.

E në fund fare, çfarë ndodhi? Edhe sa i takon hartës gjyqësore, të cilën po na e shesin sikur është zgjidhje e jashtëzakonshme, njerëzit atje nxjerrin paratë nga xhepi. Vazhdoni e gënjeni ju, s'ka problem. Ata vuajnë. Ju thoni: s'ka gjë, le të vuajnë. Kjo është mënyra se si arsyetoni ju. Ata po vuajnë. Po cili është numri? Kë do të gënjeni? Do të gënjeni se ky mali i madh i dosjeve, që ka një numër kaq të vogël gjyqtarësh, do të zgjidhet? Jo more, jo, nuk zgjidhet. Mungojnë 47 % e gjyqtarëve në sistem. Kjo jo me shifrat e mia, por me shifrat e raportuara zyrtarisht.

Bëmë reformë që të kishim standarde të larta. Cili është standardi. Kemi 8 gjyqtarë për 100 mijë banorë, nga minimumi 22 për 100 mijë, që duhet të ketë standardi normal. Pra, vetëm arritëm një mrekulli: kapje në grusht, krijimin e kooperativës rilindëse në drejtësi dhe pandëshkueshmërinë absolute, për t'i dhënë mundësi korrupsionit, që ka shkatërruar edhe drejtësinë edhe shtetin, të ecë e të përparojë i pacenuar.